




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
MINISTRI



100 Vjet Pavarësi

*6388* Prot.

Tiranë, më *19.11.* 2012

**URDHËR**

Nr. *560*, datë *19.11.* 2012

**PËR**

**ZHVILLIMIN E KONKURSIT PËR PËRGJEGJËS TË ZA BULQIZË, PËRGJEGJËS TË ZA MAT, PËRGJEGJËS TË ZA HAS, PËRGJEGJËS TË ZA DEVOLL, PËRGJEGJËS TË ZA KOLONJË, PËRGJEGJËS TË ZA PEQIN, PËRGJEGJËS TË ZA LIBRAZHD, PËRGJEGJËS TË ZA TEPELENË, PËRGJEGJËS TË ZA KUÇOVË, PËRGJEGJËS TË ZA PËRMET DHE PËRGJEGJËS TË ZA KURBIN**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Vendimit të KM nr. 66, datë 03.02.2010, "Për krijimin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore", i ndryshuar; Urdhrit të Kryeministrit nr. 199, datë 01.12.2010 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore", i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 07.03.2003 "Për emërimin, lirimimin dhe shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose ministrit",

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen e konkursit për postet Përgjegjës të Zyrës Arsimore Bulqizë, Përgjegjës të Zyrës Mat, Përgjegjës të Zyrës Has, Përgjegjës të Zyrës Devoll, Përgjegjës të Zyrës Kolonjë, Përgjegjës të Zyrës Peqin, Përgjegjës të Zyrës Librazhd, Përgjegjës të Zyrës Tepelenë, Përgjegjës të Zyrës Kuçovë, Përgjegjës të Zyrës Përmet dhe rishpallje për Përgjegjës të Zyrës ZA Kurbin.
2. Kërkesat për konkurrim dhe mënyra e zhvillimit të konkursit për drejtuesit e ZA-ve jepen në Lidhjen 1, pjesë e këtij Urdhri.
3. Afati i fundit i dorëzimit të dokumenteve nga ana e kandidatëve do të jetë data 03.12.2012.
4. Konkurrimi për Përgjegjës të ZA Bulqizë, Përgjegjës të ZA Mat, Përgjegjës të ZA Has, Përgjegjës të ZA Devoll, Përgjegjës të ZA Kolonjë të zhvillohet në MASH, në datën 07.12.2012.

5. Konkurrimi për Përgjegjës të ZA Peqin, Përgjegjës të ZA Librazhd, Përgjegjës të ZA Tepelenë, Përgjegjës të ZA Kuçovë, Përgjegjës të ZA Përmet dhe Përgjegjës të ZA Kurbin të zhvillohet në MASH, në datën 11.12.202.
6. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal, në bashkëpunim me ZA Bulqizë, ZA Mat, ZA Has, ZA Devoll, ZA Kolonjë, ZA Peqin, ZA Librazhd, ZA Tepelenë, ZA Kuçovë, ZA Përmet dhe ZA Kurbin, të shpërndajë këtë Urdhër në të gjitha drejtoritë e shkollave të juridiksionit të tyre, deri në datën 23.11.2012.
7. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal të bëjë shpalljen e konkursit në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në revistën “Mësuesi” dhe në faqen elektronike të MASH-it, ndërsa ZA-t **Bulqizë, Mat, Has, Devoll, Kolonjë, Peqin, Librazhd, Tepelenë, Kuçovë, Kurbin dhe Përmet** në mediat e shkruara lokale.
8. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal në MASH të marrë masat për organizimin e konkursit.
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal, si dhe DAR/ZA-t përkatëse.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJAJ

MINISTËR

